VENDIM
Nr. 100, datë 12.5.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "NAD INVESTMENT" SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "e", 5, pika 1, germa "e" dhe 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.5.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1408/4 prot., datë 8.5.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'NAD Investment' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "NAD Investment" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1408 prot., datë 25.3.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 69, datë 8.5.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 9.4.2025 dhe 10.4.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 18.4.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 1408/3 prot., datë 15.4.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1408/4 prot., datë 25.4.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacion të përditësuar në lidhje me mbështetjen financiare.
- Sa i përket strukturës organizative, vlerësohet t'i kërkohet shoqërisë, që me fillimin e operimit, të njoftojë ERE-n mbi bërjen efektive të saj, referuar stafit teknik për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar.
- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "NAD Investment" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Me fillimin e operimit, shoqëria duhet të njoftojë ERE-n mbi bërjen efektive të strukturës organizative të saj, referuar stafit teknik për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "NAD Investment" sh.p.k., "OST" sh.a. dhe "ALPEX" sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të

konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti